

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 260/2020
Datë: 25/11/2020

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

Në mbështetje të Kapitullit VI nenit 92 (pika 4) dhe nenit 93 (pika 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-149 Për Shërbyses Civil të Republikës së Kosovës
Me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 05/L -021 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjit nr. 05/L-020
për Barazi Gjinore dhe Kodit nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe legjislacionit
tjetër në fuqi që ka të bëjë me punësimin në administratën publike në Kosovë.

MIRATON:

**POLITIKËN KUNDËR NGACMIMIT SEKSUAL NË ORGANET E ADMINISTRATËS
PUBLIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Neni 1

Qëllimi:

1. Qëllimi i politikës kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: Politika), është që të shërbejë si udhëzues për parandalimin e të gjitha formave të ngacmimit seksual në vendin e punës me udhëzime për sigurimin e një ambienti pune pa diskriminim dhe ngacmime seksuale në të gjitha organet administratën publike.
2. Me këtë politikë mbrohet barazia gjinore dhe trajtimi i barabartë si vlera themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, përmes ndalimit të çdo akti/sjelljeje që cënon dinjitetitn personal të secilit/ës të punësuar në organet e administratës publike.
3. Organet e administratës publike në Republikën e Kosovës duhet ta promovojnë dhe shpërndajnë këtë politikë si dhe të ndërmarrin hapa konkretë për të vetëdijësuar të gjithë të punësuarit/at në organet e administratës publike rrëth ngacmimit seksual në vendin e punës dhe mekanizmat ku duhet raportuar atë.
4. Organet e administratës publike duhet të ndërmarrin hapa në mënyrë që të sigurohet rastet e raportimit të ngacmimit seksual dhe formave tjera të ngacmimit të trajtohen në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe të besueshme, duke e respektuar konfidencialitetin e raportuesve/eve si dhe të ndërmerren masa e veprime ndëshkimore, konkrete në përshtatshmëri me rrethanat kur ngacmimi është përcaktuar se ka ndodhur.
5. Fjalët e përdorura në këtë politikë nga njëra gjini janë ekivalente për gjininë tjetër.

Neni 2

Kujt i dedikohet politika

1. Politika kundër ngacmimit seksual vlenë për të gjithë të punësuarit/at në organet e administratës publike qendrore dhe organet tjera në vartësi të tyre si dhe në organet e

administratës publike lokale dhe organet e tjera në varësi të tyre, pavarësisht llojit të kontratës së tyre.

2. Të gjithë/a të punësuarit/at në organet e administratës publike duhet të kenë trajtim korrekt dhe të paanshëm në përputhje me ligjin, ndaj nuk u lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë apo orientimit seksual.
3. Organet e administratës publike, gjatë punës së tyre, duhet të udhëhiqen nga parimet e barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.
4. Të gjithë të punësuarit në organet e administratës publike duhet t'i respektojnë standarde t'ët e njohura ndërkombe të drejtave të njeriut dhe të marrin masa që të mos lejohet asnjë formë e ngacmimit apo ngacmimit seksual siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi në Kosovë lidhur me këtë çështje.
5. Të gjithë/a të punësuarit/at në organet e administratës publike duhet ta respektojnë Politikën kundër Ngacmimit Seksual në vendin e punës dhe nuk duhet të diskriminojnë asnjë person mbi kurrfarë baze.
6. Të gjitha organet e administratës publike duhet të sigurojnë që të punësuarit e këtyre organeve t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa asnjë dallim.

Neni 3

Përkufizimi i ngacmimit seksual

Ngacmimi seksual paraqet diskriminim gjinor. Kjo është përcaktuar me ligjet në fuqi. Me ligjet në fuqi, ndalohet ngacmimi dhe ngacmimi seksual në vendin e punës.

Për qëllimet e kësaj politike, termet në vijim kanë këto kuptime:

1. -*Ngacmimi seksual* nënkuption çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar verbale, jo verbale apo fizike të natyrës seksuale dhe/ apo psikologjike, me qëllim apo pasojë prekjen apo shkeljen e

dinjitetit të një personi, dhe krijimin e një mjedisë frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes. Ngacmimi seksual në vendin e punës i referohet por nuk kufizohet në format e përcaktuara me këtë politikë:

2. *-Quid Pro Quo* (*këtë për atë*) që i referohet çdo premtimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të trajtimit preferencial/ të dëmshëm në punësim, ku refuzimi për kryerjen e favoreve seksuale mund shkaktojë mos punësim, mos-ngritjen në pozitë, ngritje të pagës, mos-pagesë.
3. *-Ambient armiqësor* - krijimi i një ambienti frikësues ose poshtërues që mund të manifestohet përmes gjuhës seksuale abuzive e cila mund t'i bëjë punëtorët të ndihen të poshtëruar dhe të diskriminuar.
4. *Ngacmimi verbal* - përfshinë por nuk kufizohet vetëm në: komente, shaka, pyetje provokuese, komente të natyrës seksuale, shprehje fyeze, epitete poshtëruese, formulime nënçmuese ose shpërdorime tjera verbale,
5. *Ngacmimi joverbal* - përfshinë por nuk kufizohet vetëm në: gjeste provokuese me lëvizje dhe prekje provokuese të pjesëve të ndryshme të trupit të vet.
6. *Ngacmimi vizual* - përfshinë por nuk kufizohet vetëm në: ekspozim të reklamave, fotografive dhe shenjave pornografike, vizatime ose komente seksuale për veshjen, stolitë apo trupin e një individi;
7. *Ngacmimi psikologjik* - përfshinë por nuk kufizohet vetëm në: ftesa për intimitet fizik seksual- Presione për të pranuar ftesa shoqërore, për takime private dhe lidhje seksuale, pyetje apo diskutime për aktivitetet seksuale, ftesa për intimitet fizik seksual. Kërkime dhe këmbëngulje/shantazhe për favore seksuale të përcjella me kërcënime ose kushtëzime të dukshme lidhur me vendin e punës, ftesa të padëshiruara shoqërore me ngjyrime seksuale që shpesh shfaqen si flirtim; Kërkesë e tërthortë për qëllime seksuale; Paraqitja jo e drejtë e punës së dikujt apo vlerësimi jo i drejtë i punës së dikujt, mohimi i trajnimeve apo ngritjes në detyrë.

8. *Ngacmimi fizik* - përfshinë: prekjen fizike, pickimin, puthjen, prekjen e rrobave, përkëdheljen dhe fërkimin e trupit të personit tjetër.
9. Ngacmimi përfshinë çdo formë të sjelljes që ka për qëllim ose që paraqet cenim të dinjitetit personal apo krijon atmosferë frikësuese, armiqësore, degraduese, poshtëruese dhe sulmuese në vendin e punës.
10. Ngacmimi që ka shkaktuar ofendim konsiderohet edhe atëherë kur është i pa qëllimitë.
11. Ngacmimi seksual mund të ndodhë me një akt të vetëm ose/dhe me akte që përsëriten me disa akte.

Neni 4

Kush mund të jetë viktimë e ngacmimit seksual?

1. Ngacmimi seksual mund t'i u ndodhë të gjithëve, pavarësisht gjinisë së tyre apo orientimit seksual. Megjithatë, praktikisht të prekurit nga ngacmimi seksual janë kryesisht janë gratë dhe vajzat.
2. Argumenti i provokimit, ka për qëllim të hedhjes së përgjegjësisë mbi viktimen dhe e dënon dyfish personin e ngacmuar, i cili jo vetëm nuk është i njojur si viktimë, por shikohet si përgjegjës për nxitjen e veprimit të ndodhur.
3. Viktima po ashtu edhe ngacmuesi/ja mund të jenë të gjinisë së njëjtë apo të gjinisë së kundërt;
4. Viktima nuk mund të jetë vetëm personi i ngacmuar, por kushdo që është i/e prekur nga sjelljet ofenduese dhe provokuese;
5. Ngacmuesi mund të jetë mbikëqyrës/e i/e viktimës, koleg, punonjës/e i/e administratës publike ose palë e tretë;

Neni 5

Pasojat e ngacmimit seksual

1. Ngacmimi seksual cënon seriozisht integritetin fizik, seksual dhe psikologjik të personit të ngacmuar dhe shënon shkelje të rëndë të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut;
2. Ngacmimi seksual rrezikon të keqësojë shumë shëndetin fizik e mendor të viktims (humbje të vetëbesimit në vetvete, dhimbje me origjinë psikosomatike, çrregullime në të ushqyer, depresion etj.)
3. Të gjitha këto ndikojnë edhe në procesin e punës, në krijimin e një ambienti të pasigurt dhe të frikshëm, prandaj nuk duhet të tolerohen në asnjë moment ngacmimet seksuale në vendin e punës.
4. Ngacmimi seksual poashtu shkakton pasoja të rënda për jetën sociale të viktims.

Neni 6

Raportimi i ngacmimeve seksuale

1. Organet e administratës publike obligohen të vendosin qartë mekanizmat dhe procedurat për raportim të ngacmimit seksual siç është përcaktuar me këtë politikë;
2. Personi që ngacmohet, siç përkufizohet në këtë politikë, nga një person tjetër në vendin e punës ose në aktivitetet për dhe rrëth punës, duhet që t'i tregojë sa më parë udhëheqësit/es të tij direkt, udhëheqësit/es më të lartë nëse udhëheqësi direkt është ngacmuesi/ja apo menaxherit/es të personelit;

3. Personi që nuk ka dëshirë ta bëjë vetë ankesën mund të ankohet nëpërmjet të autorizuarit të tij/saj;
4. Personi, i cili është në dijeni se një person ngacmon një person tjeter, duhet të raportojë te menaxheri/ja i/e personelit;
5. Menaxheri/ja e personelit duhet t'i ndjekë procedurat e raportimit pranë komisioneve gjegjëse siç rregullohet me ligjin në fuqi për shërbYESIT civilë dhe siç e përcakton politikë;
6. Ndalohet hakmarrja ndaj ndonjë personi që raporton shkelje të kësaj politike ose merr pjesë në procese që zhvillohen nga kjo politikë. Hakmarrja përfshinë, por nuk kufizohet me kërcënime, dënlime dhe ngacmime.
7. Është e dobishme për viktimin që në mënyrë të hapur t'i bëjë të ditur ngacmuesit se sjelljet e tij/saj janë të padëshirueshme dhe duhet të ndalet;
8. Viktima duhet të shfrytëzojë çdo mekanizëm të ankesës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7
Masat për zbatimin e kësaj politike

1. Të gjithë të punësuarit/et në organet e administratës publike janë të obliguar ta trajtojnë njëri-tjetrin me respekt mbi parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.
2. Të gjithë të punësuarit në organet e administratës publike qendrore dhe organet tjera në varësi të tyre si dhe në organet e administratës publike lokale dhe organet e tjera në varësi të tyre (duke përfshirë të emëruarit politikë, udhëheqësit dhe të gjithë nëpunësit civil dhe kontraktorët me organet e administratës publike), janë të obliguar që të zbatojnë këtë politikë;
3. Të organizohen takime (së paku vjetore) me të gjithë të punësuarit për informimin e tyre me politikën kundër ngacmimit seksual;

4. Një përbledhje e kësaj politike - letër njoftuese ku do të përfshihet në pikë të shkurtra politika kundër ngacmimit seksual, duhet të vendoset në një vend të dukshëm në çdo organ të administratës publike;
5. Udhëheqësi më i lartë i një organi të administratës publike (qoftë i nivelit qendror apo lokal), mbanë përgjegjësi për promovimin dhe zbatimin e politikës kundër ngacmimit seksual.
6. Organi i punësimit - udhëheqësi/ja i/e drejtpërdrejt, ka për obligim të sigurojë mbrojtje të personalitetit të personelit të tij, të marrë masa të mbrojtjes dhe të ndalojë të gjitha aktet e ngacmimeve seksuale të bëra ndaj një anëtari/je të personelit të vetë nga një bashkëpunëtorë(e), nga një person në kuadër të punës.
7. Çdo procedurë e ndërmjetësimit ose pajtimit, të cilat i parashevë legjislativi në fuqi, mund të shfrytëzohen sipas zgjedhjes së parashtruesit/es së kërkesës, për të adresuar shkeljet, edhe pse shfrytëzimi i procedurave të ndërmjetësimit ose pajtimit, nuk e përjashton mundësinë e paraqitjes së kërkesës-ankesës para organit administrativ apo Gjykatës kompetente;
8. Krijohen mekanizma monitorues të cilët do ta monitorojnë zbatimin e kësaj politike;
9. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përfshin ngacminin seksual si indikatorë në raportin vjetor të monitorimit;
10. Ngritja e kapaciteteve të personave përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj politike;
11. Autoriteti bartës vendosë qartë dhe zbaton masat ndëshkuese në rast të ngacmimeve seksuale në Administratën Publike
12. Inkurajohen shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridikë që të iniciojnë apo përkrahin procedura ligjore në emër të parashtruesit/ve, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për zbatimin e

obligimeve të organeve të administratës publike në politikën kundër ngacmimit seksual;

13. Obligohen të gjitha organet e administratës publike të bashkëpunojnë ngushtë me Avokatin e Popullit të Kosovës për të gjitha ankesat kundër ngacmimit seksual në vendin e punës.


Neni 8

Parandalimi i ngacmimit seksual në vendin e punës

1. Organet e administratës publike ndërmarrin hapa të domosdoshëm, me qëllim të parandalimit dhe mënjanimit të ngacmimit seksual në vendin e punës. Ata duhet në mënyrë të qartë t`i njoftojnë të punësuarit/at se ngacmimi seksual është i patolerueshëm dhe në të njëjtën kohë është edhe i dënueshëm.
2. Masat parandaluese duhet t`i përfshijnë (duke mos u kufizuar vetëm në to), këto elemente:
 1. Organet e administratës publike në praktikat e tyre duhet të krijojnë kushte adekuate për t'u mundësuar të gjithë të punësuarve të punojnë pa frikën e ngacmimit.
 2. Të gjithë/a të punësuarit/at informohen drejt për politikat kundër diskriminimit dhe rregulloret e brendshme kundër ngacmimeve seksuale;
 3. Zhvillimin e programeve vetëdijësuese me qëllim të sqarimit dhe promovimit të politikës kundër ngacmimit seksual;
 4. Të saktësohen procedurat dhe mekanizmat brenda-institucional ku mund të raportohet ngacmimi seksual në administratën publike;
 5. Të ndërmerren masa mbrojtëse kur një i/e punësuar raporton se është ngacmuar seksualisht.

Neni 9
Mekanizmat përgjegjës për zbatimin e kësaj politike

1. Zyra e Kryeministrat /Zyra për Qeverisje të Mirë obligohet të merr masa dhe veprime në zbatim të kësaj politike si vijon;
2. Do të zhvillojë fushata nationale vetëdijesuese në nivel qëndror dhe lokal të qeverisjes
3. Do te monitorojet procesin e funksionimit të komisioneve disiplinore në nivel të administratës në përputhje me ligjet në fuqi
4. Do te punoje ngushtë me organizata e shoqërisë civile dhe institucionet në ngritjen e kapaciteteve të institacioneve në nivel qendror dhe lokal në zbatim të kësaj politike

Aydullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës